



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCEVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës

Nxjerr:

Vendim Shpjegues Publik

për

Depozitat e Organizatave Joqeveritare me status të Përfituesit Publik

1. Qëllimi i Vendimit Shpjegues:

1.1. Ky vendim shpjegues rregullon trajtimin për çështje tatimore të pagesës së interesit nga institucionet financiare, personave të cilët janë të regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/22, “Mbi Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë” apo më pas me Ligjin Nr. 03/L-134, “Ligji për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare”, të cilat kanë marrë dhe kanë mbajtur statusin e përfitimit publik për aq sa depozitat dhe interesi i paguar apo i kredituar në lidhje me ato depozita, janë përdorë ekskluzivisht për qëllime të përfitimit publik.

2. Historiku juridik:

2.1. Paragrafi 1 i nenit 27 të Ligjit 03/L-113 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, parasheh që, “secili tatimpagues që paguan dividendët, kamatat apo të drejtën pronësore personave rezident apo jo-rezident, mban në burim tatimin prej dhjetë përqind (10%) në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe e transferon tatimin e mbajtur në burim në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në bankën e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

2.2. Ligji Nr. 03/L-113 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, parasheh që ‘Person’ nënkupton një person fizik ose një person juridik.

2.3. Neni 2 i Ligjit Nr. 03/L-113 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, parasheh që, “Sipas këtij ligji tatimpagues janë personat e mëposhtëm:

- një korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
- një ndërmarrje afariste që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- një organizatë e regjistruar si organizatë joqeveritare në bazë të legjislacionit mbi regjistrimin dhe punën e organizatave joqeveritare në Kosovë; dhe
- Person jo rezident me ndërmarrje të përhershme në Kosovë, duke iu nënshtruar dispozitës së paragrafit 2 të nenit 3 të këtij ligji.”

2.4. Neni 29 i Ligjit Nr. 03/L-113 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, parasheh që, “Organizatës joqeveritare, e cila ndërmerr aktivitete komerciale ose aktivitete të tjera që nuk janë të lidhura me qëllimin e saj të përfitimit publik, i caktohet tatimi në të ardhur në shkallë prej dhjetë për qind (10%) për të ardhurën nga një aktivitet i tillë i pa ndërlidhur biznesi, të zvogëluar nga cilado zbritje, e cila është drejtpërdrejt e lidhur me kryerjen e biznesit të tillë dhe e cila është e lejuar nga Administrata tatimore.”

2.5. Nenet e sipërme të Ligjit Nr. 03/L-113 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave rezultojnë që të ardhurat nga interesi për një OJQ-të me status të përfitimit publik i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim në interes të paraparë në nenin 27 të këtij ligji. Nuk është bërë dallim në dispozitat e mbajtjes në burim në mes të personave të cilët mund të jenë të liruar nga tatimi (por ende janë tatimpagues) dhe personave që nuk lirohen nga tatimi. Arsye kryesore për atë rezultat është se nuk i përket një institucioni financiar të përcaktojë se depozitat në institucionin e tyre a rezultojnë nga fitimet e dala nga aktivitetet komerciale apo nga aktivitetet e një organizate që operon për përfitim publik.

2.6. Duhet të ceket se ligji i ndryshuar i OJQ-ve është miratuar nga Kuvendi në Shkurt 2009 (Ligji Nr. 03/L-134, “Ligji për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare”), i cili ka zëvendësuar legjislacionin mbi Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Joqeveritare në Kosovë, për të cilin referimi është bërë në paragrafin 2.3 më sipër. Ligji i ndryshuar i lartpërmendur nuk ndryshon faktin se një OJQ është tatimpagues për qëllime të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, edhe nëse OJQ ka marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik, apo jo.

3. Çështje:

3.1. Një organizatë e regjistruar si organizatë jo-qeveritare (OJQ) sipas legjislacionit mbi Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë, apo pasardhësit të tij Ligji Nr. 03/L-134 “Ligji për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare”, i nënshtrohet mbajtjes në burim të tatimit në interesin e paguar apo të kredituar në lidhje me depozitat e vendosura në institucionet financiare. Në të njëjtën kohë, OJQ është liruar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave mbi të ardhurat që lidhen me qëllimet për të cilat është dhënë statusi i përfitimit publik. Një OJQ kërkohet të dorëzojë një deklaratë vjetore të tatimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 03/L-113 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Mbipagesat e tatimit të mbajtur në burim mund të kërkohen që të rikthehen vetëm me deklaratë vjetore. Kjo nënkupton se një OJQ me status me përfitim publik nuk mund t’i përdorë paratë e mbajtura në burim para se të ketë marrë rimbursimin e atyre parave të mbajtura në burim. Ky vendim shpjegues lëshohet me qëllim të zgjidhjes së këtij shqetësimi.

Biff

4. Dispozitiv:

4.1. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të Nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-113 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, depozitat në institucionet financiare të bëra nga OJQ-të me status të përfitimit publik **nuk i nënshtrohen mbajtjes në burim të tatimit në interesin e paguar apo të kredituar në lidhje me ato depozita përderisa:**

- 4.1.1. OJQ i jep institucionit financiar një certifikatë të lëshuar nga organi kompetent sipas legjislacionit mbi Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-Qeveritare apo pasuesin e tij, që konfirmon se OJQ ka marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik;
- 4.1.2. OJQ i vërteton institucionit financiar se fondet në depozita janë për përdorim nga ajo në aktivitetet jo-komerciale për të cilën ata kanë marrë statusin e përfitimit publik;
- 4.1.3. OJQ i vërteton institucionit financiar se interesi i fituar mbi depozitat do të përdoret në aktivitetet jo-komerciale për të cilat OJQ ka marrë statusin e përfitimit publik.

5. Data efektive:

Ky vendim shpjegues do të ketë efekt në lidhje me interesin e paguar apo të kredituar nga institucionet financiare mbi llogaritë e kualifikuara (llogaritë e certifikuara nga OJQ-të sikurse është paraparë në 4.1.1 deri në 4.1.3 të këtij vendimi shpjegues) më dhe pas 1 Korrikut 2009.

Drejtor i përgjithshëm i ATK-së
Behxhet Haliti



Data
15/07/2009